

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit M.H. nga komuna V., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, veprës penale mbajtja në pronësi ,kontrolle, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit , paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.57/14 të datës 31.10.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 281/2017 datë 13.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1.Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit M.H., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.57/2014 datë 31.10.2016, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.281/2017 datë 13.06.2017, ashtu i dënuari M.H. në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPPK

LIROHET NGA AKUZA

Sepse me datën 28.08.2013, rreth orës 11.20 minuta, në pompën e benzinës “ A.-P” në fsh.Sh., komuna e M., ka përdorur në mënyrë kërcënuese-frikësuese pistoletën e markës “Cervena Zastava”, M-57,i kalibrit 7.62 x 25 mm, me nr.serik: E- 57622, duke shtënë në të dëmtuarin E.M., për shkak të një zënke rreth vendosjes së sasisë së naftës në automjet.

Me çka kishte për të kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 KPRK .

Shpenzimet e procedurës penale në këtë pjesë bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

2. Sa i përket veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK dhe dënimit unik me gjobë të shqiptuar për këto vepra penale në shumën e përgjithshme prej 1.300 euro , aktgjykimi në këtë pjesë mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.57/2014 datë 31.10.2016 të dënuarin M.H. e ka shpallur fajtor për veprën penale I. përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, II. veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe për veprën penale nën III. lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK, dhe për veprën penale nën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve dhe dënimin me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) euro, për veprën penale nën II, i shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro ,dhe për veprën penale nën III i shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 800(tetëqind) euro. Gjykata në mbështetje të nenit 80 të KPRK të dënuarit M.H. i shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.08.2013 deri me 13.10.2013. dhe dënimin unik me gjobë në shumën prej 2,300 (dymijë e treqind) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, por jo më larg se tre muaj nga plotfuqishmëria. Në rast se i dënuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, gjykata do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim i llogaritet e barabartë me 20 euro gjobë. Obligohet i dënuari M.H. të kompensojë të dëmtuarin E.M., për kërkesën pasurore juridike. Obligohet i dënuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale për shpenzime të ekspertit mjeko ligjor, konkretisht për ekspertizën mjeko ligjore shumën prej 20 euro. Në mbështetje të nenit 69 e në lidhje me nenin 282 të KPRK, gjykata të dënuarit i ka shqiptuar dënimin plotësues, ashtu që urdhërohet konfiskimi i përhershëm, i armës, pistoletë me nr. serik M-57, kalibër 7.62 mm, me nr. serik E-57622 një karikator dhe 6 fishekë të kalibrit 7.62 mm. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi arma dhe municioni duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit, me aktgjykimin PAKR.nr.652/2016 datës 06.02.2017, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, mbrojtësi i të dënuarit av. M.H., nga P. ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, sipas së cilës kërkesë Gjykata Supreme e

Kosovës me aktgjykimin Pml.nr. 58/2017 të datës 27.04.2017, duke e miratuar kërkesën e mbrojtësit ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.652/16 të datës 06.02.2017 vetëm në raport me veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK ndërsa sa u përket veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK dhe dënimet e shqiptuar me gjobë për këto vepra penale aktgjykimet kanë ngelur të paprekura.

Në procedurën e rivendosjes Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.281/17 të datës 13.06.2017, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.57/16 të datës 31.10.2016 vetëm përkitazi me vendimin për dënimin për veprën penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK ashtu që të dënuarit i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) euro.

Kundër këtyre aktgjykimeve mbrojtësi i të dënuarit, av. M.H. ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së Ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPPK, aktgjykimin e gjykatës së Apelit ta ndryshoi ashtu që duke gjetur se vepra për të cilën i dënuari është shpallur fajtor nuk përbënë veprë penale (neni 364 par.1 pika 1.1 të KPPK) ose të ndryshohet në pikëpamje të vendimit mbi dënimin.

Ndaj kërkesës është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.175/2017 datë 21.09.2017, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur këto pretendime: gjykata e shkallës së dytë nuk e ka shqyrtuar fare aktgjykimin e shkallës së parë dhe as pretendimet ankimore të mbrojtësit, cilësimi i veprës penale i ka kaluar normat kualifikuese të veprës penale, është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, me rastin e shqiptimit të dënimit prej 6 muajve për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, pasi që në veprimet e tij nuk sajohen elementet konstitutive të kësaj veprë penale (kërcënimi ose frikësimi). Kjo për arsye se siç rezulton nga norma blankete e kësaj dispozite, veprë penale në fjalë e kryen “Kushdo që përdorë armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese..”, ndërsa në rastin konkret e njëjta është përdorur dhe ky përdorim ka rezultuar me kryerjen e një veprë tjetër penale plagosja e lehtë trupore , për çfarë kalon suazat e rregullativës së

normës kualifikuese të veprës pra përdorimit të armës në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, që në situatën e tillë veprimi ka kaluar nga sfera e kërcënimit, duke shkaktuar pasojën konkrete për viktimën, faza e rrezikimit abstrakt është kapërcyer dhe ka shkaktuar pasojë konkrete lëndim trupor të lehtë.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit, për faktin se ai është shpallur fajtor për tri vepra penale edhe atë për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, sipas dispozitivit nën I, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK sipas dispozitivit nën II dhe për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK, sipas dispozitivit nën III.

Sipas dispozitës së nenit 375 par.2 të KPRK vepra penale e përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK ekziston atëherë kur kryesi e përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese.

Në rastin konkret siç rezulton nga shkresat e lëndës, aktgjykimi i kundërshtuar dhe dispozitivi nën III i aktgjykimit, ku theksohet “ Në të njëjtën ditë, vend dhe kohë si në pikën I të dispozitivit të akuzës dhe aktgjykimit pas një fjalosje me të dëmtuarin.... i dënuari e nxjerr pistoletën e markës “Cervena Zastava”, dhe shtënë gjuajte njëherë në drejtim të dëmtuarit, me ç, rast e godet atë dhe i shkakton plagë në regjionin e gjurit të majtë. Pra, me këtë rast arma është përdorur dhe ky përdorim ka rezultuar me kryerjen e një veprë tjetër penale (lëndim i lehtë trupor) nën dispozitivin III , për çfarë kalon suazat e rregullativës së normës kualifikuese të veprës pra përdorimit të armës “ Në mënyrë kërcënuese ose frikësuese”, që në situatën e tillë veprimi ka kaluar nga sfera e kërcënimit, duke shkaktuar pasojën konkrete për viktimën, faza e rrezikimit abstrakt është kapërcyer dhe ka dalë në fazën e lëndimit. Nga kjo rezulton se me veprimin e shkakimit të pasojës (në këtë rast me shkakimin e lëndimit të lehtë trupor (është konsumuar kjo vepër penale, ashtu që i dënuari M.H. nuk ka mundur të shpallet fajtor për këtë vepër penale .

Për këtë arsye aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë u ndryshuan dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,

Meqenëse kjo Gjykatë e ndryshoi aktgjykimin, veprimet e të dënuarit përkritazi me dispozitivin nën I respektivisht veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK u konsumuan me veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK.

Në pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me dispozitivin nën II dhe III me veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK dhe lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK, aktgjykimi ngelë i pashqyrtuar ngase në këtë pjesë nuk kundërshtohet me kërkesë. Edhe dënimi me gjobë në shumën prej 1300 Euro ngeli i paprekur.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, e në kuptim të nenit 438 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 15.03.2017, Pml.nr.252/2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta